



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 97/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, për shkak të hapësirave për vendosjen e billbordeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në seancën e panelit të mbajtur me 03.06.2014 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), në Malishevë

Arsyetim

PZAP-i, me datën 31.05.2014 ka pranuar një ankesë, nga Partia Demokratike të Kosovës (PDK), në Malishevë në të cilën thekson se të premtën pasdite më dt. 30.05.2014 hapësirat për vendosjen e billbordeve dhe materialit tjetër propagandues subjektit politik Nisma kanë vendosur billbordet e tyre në vendin në të cilin ishte i rezervuar për billbordet e subjektit politik PDK.

Parashtruesi i ankesës shton se kanë biseduar me kompaninë e caktuar për vendosjen e billbordeve dhe materialit tjetër zgjedhor, dhe se ata iu janë përgjigjur se nga 16 ballina sa janë në qytetin e Malishevës, vetëm një hapësirë ju është lënë PDK-së dhe se këtë hapësirë e ka zënë Nisma.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 122 paragrafi 1 pika a), subjektin politik Nisma e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarri masat përmirësuese lidhur me ankesën më datën 02.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 02.06.2014 në ora 10:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga Nisma, në të cilën theksohet se ankesa është e palejuar dhe adresuar gabimisht pran PZAP-it sepse sipas tyre nuk është në mandatin e tij të vendos lidhur me këtë çështje. Lidhur me shfrytëzimin e hapësirave për reklamën e partive politike nuk vendos Nisma por vendos kompania e cila është kontraktuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës.

Ata shtojnë se hapësirat tjera i shfrytëzojnë të gjitha subjektet politike si PDK, LDK, VV, NISMA etj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj Ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore për uzurpimin e hapësirës propaganduese për vendosjen e billbordeve nga ana e subjektit politik Nisma për Malishevën, nuk qëndrojnë pasi në bazë të shkresave të lëndës të ofruar nga pala nuk mund të vërtetohet kjo hapësirë ka qenë e dedikuar për subjektin politik PDK ngase ankesë nuk është bashkangjitur ndonjë marrëveshje kontraktuese e lidhur në mes të Drejtorisë Shërbimeve Publike të Komunës së Malishevës dhe subjektit politik PDK-së. Si dhe në bazë të disa fotove të bashkangjitura në Përgjigje në Ankesë shihet se nëpër hapësirat propaganduese në qytetin e Malishevës gjenden posterat e shumë nga subjektet garuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 8 qershor.

PZAP-i në mungesë të provave, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 lidhur me neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 97/2014 më datën 03.06 .2014.

**Kryesuesi Panelit
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*